



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 382 Prot.

Tiranë, më datë 23 . 08 .2024

VENDIM
Nr. 337, datë 23.08.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 23.08.2024:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit “Ndërtimi, shfrytëzimi dhe administrimi i Centralit Gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhues 2MW dhe veprave ndihmëse, në Zonën Kadastrale nr. 3038, në fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier”, me zhvillues subjektin “Delta Plan Studio” sh.p.k;
2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve për projektin “Ndërtimi, shfrytëzimi dhe administrimi i Centralit Gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhues 2MW dhe veprave ndihmëse në Zonën Kadastrale nr. 3038, në fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier”, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjektin aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Sokol ISMAILI

